


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Qershor 2023

**Tiranë, më 17 Korrik 2023:** Në Qershor 2023 eksportet e mallrave arritën vlerën 38 mld lekë, duke u ulur me -17,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me -4,0 %, në krahasim me Maj 2023. Importet e mallrave arritën vlerën 75 mld lekë, duke u ulur me -7,5 %, në krahasim me një vit më parë dhe me -6,8 %, në krahasim me Maj 2023. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 37 mld lekë, duke u rritur me 5,4 %, krahasuar me Qershor 2022 dhe ulur me -9,6 %, në krahasim me Maj 2023.

Fig.1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë gjashtëmuor eksportet e mallrave arritën vlerën 234 mld lekë, duke u ulur me -7,4 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 439 mld lekë, duke u ulur me -1,6 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 204 mld lekë, duke u rritur me 5,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Qershor 2023, në uljen e eksporteve prej -17,3 %, kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -9,7 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,5 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -4,4 pikë përqindje, etj. Ndërsa, pozitivisht ka ndikuar grupi: “Ushqime, pije, duhan” me +4,6 pikë përqindje.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Qershor 2023**




Eksportet, gjatë këtij gjashtëmujori janë ulur me -7,4 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,2 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -1,0 pikë përqindje, etj. Ndërsa, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +2,1 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,8 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Qershor 2023, në uljen e importeve prej -7,5 %, krahasuar me Qershor 2022, negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -7,9 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,9 pikë përqindje, etj. Ndërsa, pozitivisht ka ndikuar grupi: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,2 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Qershor 2023**



Si gjashtëmuor, importet janë ulur me 1,6 %, krahasuar me gjashtëmuorin e parë 2022. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,9 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me -0,5 pikë përqindje, etj. Ndërsa, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,4 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,7 pikë përqindje.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Qershor 2023, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Qershor 2022 janë: Italia (9,4 %), Greqia (40,7 %) dhe Spanja (47,9 %). Ndërsa, vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritje më të madhe, janë: Zvicra (34,8 %), Kina (10,1 %) dhe Ukraina (63,0 %).

Gjatë këtij gjashtëmuor vendet me të cilat Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (10,6 %), Gjermania (30,3 %) dhe SHBA (57,8 %). Ndërsa, vendi me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, është: Spanja (67,0 %), Greqia (16,1 %) dhe Maqedonia (12,4 %).

Në muajin Qershor 2023, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Italia (6,4 %), Kosova (46,5 %) dhe Rusia (77,3 %). Ndërsa, vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me Qershor 2022 janë: Kina (50,6 %), Gjermania (15,2 %) dhe SHBA (48,8 %).

Gjatë këtij gjashtëmuor, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (18,4 %), Greqia (11,9 %) dhe Italia (3,8 %). Ndërsa, vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe janë: Kina (39,7 %), Zvicra (103,1 %) dhe SHBA (49,0 %).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Qershor 2023



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 59,2 %, të gjithë tregtisë. Në Qershor 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,6 %), Kina (9,0 %), Turqia (7,2 %) dhe Greqia (6,8 %).

Shkëmbimet tregtare, për gjashtëmuajorin e parë 2023, me vendet e BE-së zënë 59,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar - Qershor 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,2 %), Kina (7,6 %), Turqia (7,0 %) dhe Greqia (6,8 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Qershor 2023

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	Janar- Qershor 20	125	-17,7	271	-14,6	-146	46,2
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	Janar - Qershor 21	177	40,9	354	30,5	-178	49,9
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	Janar- Qershor 22	253	43,3	446	25,9	-193	56,7
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	Janar- Qershor 23	234	-7,4	439	-1,6	-204	53,4

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Qershor 2023

	Eksporte				Importe			
	Qershor 2022	Qershor 2023	Jan, - Qershor 2022	Jan, - Qershor 2023	Qershor 2022	Qershor 2023	Jan, - Qershor 2022	Jan, - Qershor 2023
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>34.610</b>	<b>28.819</b>	<b>185.493</b>	<b>173.571</b>	<b>41.510</b>	<b>38.211</b>	<b>235.484</b>	<b>225.480</b>
Austri	440	315	2.087	2.187	602	567	3.305	3.637
Gjermani	2.672	1.689	18.498	12.887	4.474	5.155	27.667	30.221
Greqi	4.156	2.463	13.925	16.172	5.367	5.186	33.309	29.330
Itali	18.225	16.520	115.694	103.390	18.174	17.009	104.079	100.150
Spanjë	3.339	1.738	5.700	9.516	1.364	913	6.929	6.403
Kroaci	804	475	4.356	3.106	886	841	4.022	3.459
Të tjera të BE-së	4.975	5.619	25.233	26.314	10.641	8.541	56.174	52.280
Mbretëri e Bashkuar	409	171	1.137	852	606	672	3.687	4.221
Kinë	933	1.027	6.971	4.295	6.092	9.173	33.495	46.784
Kosovë	3.536	3.434	19.345	20.375	1.615	865	7.568	5.411
Maqedonia e Veriut	1.449	871	8.986	10.100	1.080	967	7.704	6.778
Rusi	8	0	12	8	926	211	5.686	2.581
SHBA	625	304	5.296	2.235	1.051	1.564	5.962	8.880
Turqi	553	285	3.444	2.221	8.574	7.909	55.044	44.914
Ukrainë	31	51	273	995	249	309	2.042	1.981
Zvicër	299	403	2.266	3.014	516	738	3.763	7.644
Të tjera	3.618	2.745	19.838	16.618	18.941	14.477	85.600	84.040
<b>Gjithsej</b>	<b>46.069</b>	<b>38.110</b>	<b>253.062</b>	<b>234.286</b>	<b>81.160</b>	<b>75.096</b>	<b>446.035</b>	<b>438.714</b>

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Qershor 2023

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Qershor 2022	Qershor 2023	Janar - Qershor 2022	Janar - Qershor 2023	Qershor 2022	Qershor 2023	Janar - Qershor 2022	Janar - Qershor 2023
<b>Gjithsej</b>	<b>46.069</b>	<b>38.110</b>	<b>253.062</b>	<b>234.286</b>	<b>81.160</b>	<b>75.096</b>	<b>446.035</b>	<b>438.714</b>
Ushqime, pije, duhan	5.029	7.172	25.348	30.607	13.278	12.750	71.545	69.266
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	8.723	6.638	56.618	50.929	13.487	7.105	69.399	49.647
Produkte kimike dhe plastike	3.284	1.275	10.276	7.829	10.200	10.051	56.988	59.889
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	260	206	1.531	1.566	1.436	1.168	9.024	7.703
Prodhime druri dhe letre	1.158	911	6.795	5.969	3.224	2.837	17.181	15.331
Tekstile dhe këpucë	12.016	10.999	68.407	68.102	8.904	8.071	50.133	48.414
Materiale ndërtimi dhe metale	10.788	6.327	59.046	41.946	10.956	10.233	68.222	64.210
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	3.715	3.535	19.025	20.926	16.403	19.795	87.011	106.456
Të tjera	1.096	1.047	6.018	6.411	3.272	3.088	16.532	17.798

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Qershor 2023**

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
<b>Gjithsej</b>	<b>115.694</b>	<b>103.390</b>	<b>19.345</b>	<b>20.375</b>	<b>13.925</b>	<b>16.172</b>	<b>18.498</b>	<b>12.887</b>
Ushqim, pije duhan	5.558	7.880	2.839	3.307	1.902	2.346	784	945
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	15.678	5.604	3.021	4.093	1.614	5.793	11.033	4.953
Produkte kimike dhe plastike	2.395	3.093	2.165	2.060	2.673	577	28	25
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.421	1.485	8	7	21	14	2	2.9
Prodhime druri dhe letre	4.148	3.572	664	561	1.028	939	190	70
Tekstile dhe këpucë	53.595	53.212	97	122	2.944	3.602	4.305	5.070
Materiale ndërtimi dhe metale	19.814	14.410	8.842	8.216	3.243	2.273	745	764
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	10.125	11.274	1.004	1.119	80	65	1.194	877
Të tjera	2.960	2.860	706	892	421	566	217	180

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Qershor 2023**

	Itali		Kinë		Turqi		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
<b>Gjithsej</b>	<b>104.079</b>	<b>100.150</b>	<b>33.495</b>	<b>46.784</b>	<b>55.044</b>	<b>44.914</b>	<b>27.667</b>	<b>30.221</b>
Ushqim, pije duhan	13.695	13.342	710.3	966	3.401	3.179	2.880	2.907
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	2.812	3.345	2.5	24	3.932	6.107	517	478
Produkte kimike dhe plastike	12.915	12.567	3364.2	3.910	5.940	6.312	6.341	5.938
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.269	6.308	432.6	377	264	169	30	38
Prodhime druri dhe letre	3.735	3.402	505.7	924	2.958	2.607	605	469
Tekstile dhe këpucë	25.472	23.204	5276.7	5.961	9.329	7.517	1.154	1.322
Materiale ndërtimi dhe metale	13.785	13.724	3758.5	6.429	20.428	10.562	821	966
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	20.470	19.993	16117.7	24.831	6.242	6.307	14.343	17.006
Të tjera	3.925	4.265	3327.0	3.361	2.551	2.154	975	1.098

# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

[nomenklatura-2023-vkm-nr883-date-27122022 \(dogana.gov.al\)](http://dogana.gov.al/nomenklatura-2023-vkm-nr883-date-27122022)

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri